



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT DHE SPORTIT
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02 datë 14.01 2026

PËR

**“KRITERET PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË
EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6% TË FONDIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE”**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Në ligjin Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI

1. Të miratohen Kriteret Specifike për vitin 2026 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikëzimit.
 1. Familje te varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme,që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.
 2. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me aftësi të kufizuar/invalid pune.
 3. Familje me shumë fëmijë.
 4. Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme,dhe me probleme sociale.
 5. Persona qe jetojnë te vetëm ,të moshuar, që kanë dhe probleme shendetesore .
 6. Familje me te ardhura te pamjaftueshme që ka në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.
 7. Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.

8. Familje që kanë në përbërje të moshuar, që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
9. Kryefamiljare gra të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme.
2. Dokumentat e aplikuesve janë sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"
3. Masa e ndihmës ekonomike llogaritet sipas VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Fuqizimit Ekonomik.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR
Aleksandra Gjoni



Konceptoi:

Përgjegjës/ Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Pak

Eraldo Geci

A blue ink signature of Eraldo Geci.

Konfirmoi bazën Ligjore:

Drejtoria Juridike:

A blue ink signature of the Legal Directorate, consisting of two distinct signatures.